



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**



Sheshi "Skënderbej", No. 1, Tirana - Albania • **Tel:** ++355 4 222230; 222750; 235568  
• **Fax:** ++355 4 223558 • **Website** [www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org) • **E-mail:** [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)

## **DEKLARATË PËR SHTYP**

### **ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2005**

**Tiranë, 05 tetor 2005**

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për gjashtëmujin e parë të vitit 2005 rezultoi me një tepriçë prej 11 milionë eurosh. Flukset hyrëse të kapitalit kanë qenë plotësisht të mjaftueshme për të përballuar nivelin e deficitit korent.

Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm të ekonomisë shqiptare mund t'i përgjithësojmë në:

- Aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm, i shprehur në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente.
- Thellim i deficitit korent dhe i atij tregtar.
- Pakësim i flukseve hyrëse në formën e investimeve të huaja direkte.
- Rënie e nivelit të huamarrjes private, në krahasim me një vit më parë.
- Rritje e pretendimeve të vendit ndaj jorezidentëve, e shprehur kryesisht në rritje të investimeve të portofolit me jashtë.
- Rritje e njëkohëshme e mjeteve dhe e detyrimeve të huaja dhe rritje e rezervave valutore të autoritetit monetar.

## **I. Llogaria korente**

Transaksionet korente, të zhvilluara gjatë gjysmës së parë të vitit 2005, vlerësohen në rreth 2.8 miliardë euro ose 23 për qind më të larta se në vitin paraardhës. Shkëmbimet tregtare në mallra dhe shërbime kryesojnë vëllimin e transaksioneve korente të Shqipërisë me botën. Mëse 93 për qind e shpenzimeve korente, gjatë kësaj periudhe, kanë shkuar për blerje mallrash dhe shërbimesh. Rreth 41 për qind e të ardhurave korente kanë hyrë në formën e transfertave korente, ndërkohë që shërbimet dhe eksportet e mallrave siguruan përkatësisht 33 për qind dhe 20 për qind të të ardhurave. Të ardhurat faktoriale neto u rritën me rreth 26 për qind, megjithatë nuk kanë mundur të zbusin deficitin e lartë tregtar (mallra dhe shërbime). Si rezultat, llogaria korente u mbyll me një deficit prej 145 milionë eurosh, me rritje vjetore prej rreth 10 për qind.

### **I. 1. Tregtia e jashtme.**

Tendenca në rritje e aktivitetit tregtar të Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare vërehet edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2005. Në një nivel prej 1.2 miliardë eurosh, vëllimi i përgjithshëm tregtar vlerësohet të jetë 14 për qind më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Shkëmbimet tregtare në mallra përfaqësuan rreth 41 për qind të vëllimit të transaksioneve korente të zhvilluara gjatë kësaj periudhe. Ekonomia shqiptare dhe tregu i brendshëm mbeten të orientuar drejt importit, i cili vlerësohet të jetë 3.4 herë më i lartë se eksporti. Kërkesa e brendshme vazhdon të nxisë rritjen e importeve, ndërkohë që ecuria pozitive e eksporteve nuk ka mjaftuar për të ngushtuar deficitin tregtar. Shpenzimet për importe shënuan afërsisht 905 milionë euro, 114.5 milionë euro ose 15 për qind më të larta krahasuar me vitin 2004. Të ardhurat nga eksporti i mallrave u rritën me 11 për qind duke kapur vlerën 265 milionë euro.

Deficiti tregtar, në mbyllje të gjashtëmuorit kapi shifrën 640 milionë euro ose 16 për qind më i lartë sesa ai i periudhës korresponduese të vitit paraardhës. Deficiti i lartë dhe rregullisht në rritje i tregtisë së jashtme tërheq vëmendjen drejt politikave që synojnë zëvendësimin e importeve dhe nxitjen e eksporteve.

Mallrat e ndërmjetëm vazhdojnë të përfaqësojnë pjesën dërrmuese në strukturën e importeve, me 46 për qind të totalit. Vëllimi gjithmonë e në rritje i tyre flet për një ecuri pozitive të industrisë së përpunimit në vend. Gjithashtu, premtuese vlerësohet dhe ecuria e mallrave kapitalë, tregues pozitiv për nivelin e investimeve, rinovimin e bazës teknologjike si dhe prodhueshmërinë e sektorit privat. Në mbyllje të këtij gjashtëmuori kjo kategori rezultoi me ritmin e rritjes më të lartë krahasuar me kategoritë e tjera (27 për qind). Vërejmë gjithashtu, se mallrat e konsumit vazhdojnë të ruajnë një peshë të

konsiderueshme në importet totale, rreth 32 për qind, peshë kjo që ka ardhur lehtësisht në rënie krahasuar me gjashtëmuorin e parë të vitit 2004.

Kontributin kryesor në rritjen e eksporteve shqiptare e kanë dhënë riekportet (eksporte me material porositësi), të cilat vazhdojnë të jenë mbizotëruese në eksportet shqiptare, duke zënë aktualisht 67 për qind të vëllimit të përgjithshëm të tyre. Megjithatë, vlen të theksohet tendenca në rritje e eksportit të brendshëm sidomos gjatë tremujorit të dytë, duke mbetur brenda tendencave sezonale që karakterizojnë ecurinë e kësaj kategorie eksporti. Të ardhurat nga eksporti për përpunim aktiv vlerësohen 5 për qind më të larta kundrejt gjashtëmuorit të parë të vitit të kaluar.

## **I. 2. Zhvillimet në zërat e tjerë të llogarisë korente.**

Tregtia në shërbime, me ritme rritëse edhe gjatë kësaj periudhe, po shndërrohet gjithnjë e më shumë në një element të rëndësishëm të integritimit me jashtë për Shqipërinë. Transaksionet tregtare në shërbime arritën në 925 milionë euro dhe vlerësohen 20 për qind më të larta, krahasuar me gjashtëmuorin e parë të vitit 2004. Llogaria e shërbimeve u mbyll me një bilanc negativ prej 43 milionë eurosh, duke qenë mjaft më i lartë se ai prej 6 milionë eurosh, i regjistruar në fund të gjashtëmuorit të parë të vitit 2004. Ky deficit ka ardhur kryesisht si pasojë e një bilanci negativ në kategorinë "shërbime të tjera" kundrejt një suficiti të vërejtur në këtë kategori vitin e kaluar, si dhe e ngushtimit të suficitit të zërit "udhëtime".

Lëvizjet në llogarinë e shërbimeve ndikohen ndjeshëm nga zhvillimet në shërbime për "turizëm" (udhëtime), të cilat kontribuojnë në masë të konsiderueshme flukset hyrëse dhe dalëse të kësaj kategorie, përkatësisht me 72 dhe 61 për qind të totalit për këtë gjashtëmuor. Aktualisht, aktiviteti i turizmit vazhdon të përfaqësojë një nga burimet kryesore të të ardhurave në valutë për ekonominë shqiptare. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë, eksporti në turizëm, gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2005 ka gjeneruar rreth 319 milionë euro flukse të ardhurash, një vlerë kjo rreth 21 për qind më e lartë se vlera e eksporteve të mallrave. Të ardhurat nga turizmi, për gjashtëmuorin, vlerësohet të jenë 17 për qind më të larta kundrejt të njëjtit hark kohor në vitin 2004, të ndikuara kryesisht nga rritja e fluksit të shtetasve të huaj dhe e emigrantëve që kanë vizituar vendin si dhe nga rritja e lehtë e koeficientëve vlerësues të shpenzimeve ditore. Gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2005, numri i shtetasve të huaj që kanë vizituar Shqipërinë është rritur me 9 për qind, në krahasim me të njëjtën periudhë në vitin e kaluar.

Aktiviteti i përshpejtuar vërehet në kahun e shpenzimeve për turizëm, të cilat vitet e fundit kanë shfaqur norma vjetore rritjeje më të larta. Rezidentët shqiptarë kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë shtetit rreth 298 milionë euro ose sa 70 për qind e totalit të dërgesave nga emigrantët. Rritja në

shpenzimet e udhëtarëve shqiptarë jashtë është më e lartë sesa rritja në të ardhura, duke shkaktuar ngushtimin e bilancit pozitiv të kësaj kategorie nga 28 në 22 milionë euro, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2005.

Kategoria "shërbime të tjera", ka rezultuar me një deficit prej 19 milionë eurosh, ndryshe nga suficiti (11 milionë euro) në gjashtëmujorin e parë të vitit 2004. Deficiti i sivjetshëm është shkaktuar kryesisht si pasojë e rritjes së shpenzimeve në kategoritë "shërbime kulturore dhe biznesi".

Ekonomia shqiptare përfiton të ardhura në valutë prej punës së punonjësve sezonalë dhe investimeve të rezervave valutore të sistemit bankar në institucionet financiare jorezidente, dhe njëkohësisht paguan interesat për borxhin e jashtëm. Rezultati neto i transaksioneve në të ardhura mbetet pozitiv edhe gjatë këtij gjashtëmujori dhe vlerësohet në rreth 66 milionë euro. Të ardhurat nga puna, në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar, janë rritur me rreth 9 milionë euro, duke arritur nivelin prej 47 milionë eurosh. Gjithashtu rritje kanë regjistruar edhe të ardhurat nga interesat prej investimit të rezervës tonë valutore në institucione jorezidente ndërkohë që, të ardhurat nga interesat e mbledhur nga investimet e portofolit të institucioneve rezidente jashtë, janë më të ulëta se ato të vitit të kaluar.

Bilanci i transfertave korentë, në fund të gjashtëmujorit të parë, u vlerësua në rreth 472 milionë euro ose 28 për qind më i lartë se ai i gjashtëmujorit të parë të vitit të kaluar. Peshën kryesore (rreth 76 për qind) të të ardhurave në këtë kategori vazhdojnë ta zënë prurjet e emigrantëve shqiptarë me banim jashtë. Gjatë kësaj periudhe këto transfertat kanë arritur nivelin 424 milionë euro, duke qenë 24 për qind më të larta se ato të të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Këto transfertat përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të deficitit tregtar (në mallra dhe shërbime) në mëse 50 për qind të tij. Prurjet nga emigrantët (424 milionë euro) janë shoqëruar edhe nga transfertat shtetërore, kryesisht në formë të asistencës teknike (18 milionë euro), të cilat vlerësohen në rënie (28 për qind).

## **II. Llogaria kapitale dhe financiare**

Flukset neto të kapitalit, gjatë këtij gjashtëmujori, regjistruan 201 milionë euro, duke mundur plotësisht financimin e deficitit korent, si dhe kontribuan në rritje të rezervave valutore. Pas kësaj shifre pozitive, qëndrojnë transfertat kapitale hyrëse prej 50 milionë eurosh si dhe bilanci pozitiv i llogarisë financiare prej rreth 151 milionë eurosh. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2004, pozicioni neto i llogarisë kapitale dhe financiare vlerësohet rreth 54 milionë euro më i ulët. Kujtojmë se gjatë gjysmës së parë të vitit 2004 janë regjistruar flukse të larta kapitali për efekt të privatizimit.

Transfertat kapitale gjatë kësaj periudhe, u rritën me rreth 1.5 milionë euro ndërkohë që, bilanci pozitiv i llogarisë financiare vlerësohet në rënie ndaj një viti më parë (me rreth 56 milionë euro). Pozicioni i llogarisë financiare këtë

tremujor përkufizohet në rritje të detyrimeve financiare të Shqipërisë me botën (me rreth 177 milionë euro) si dhe rritje të mjeteve tona jashtë (rreth 26 milionë euro). Megjithatë, krahasuar me gjashtëmuajin e parë të vitit të kaluar, fluksi neto i detyrimeve financiare vlerësohet më i ulët, rreth 78 milionë usd dhe pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës qëndrojnë, gjithashtu, në një nivel më të ulët (22 milionë euro).

Rritja e detyrimeve financiare ndaj botës, këtë gjashtëmuaj, ka ardhur kryesisht prej flukseve hyrëse të kapitalit në formën e investimeve direkte (96 milionë euro) dhe huamarrjes me jashtë (me 77 milionë euro). Investimet e huaja direkte vlerësohen të jenë 79 milionë euro më të ulëta kundrejt të njëjtit hark kohor në vitin 2004, periudhë në të cilën mëse 60 për qind e fluksit të IHD-ve ka hyrë në formën e privatizimit.

Lëvrimet e kredive afatgjata dhe të atyre të buta nga jashtë, të cilat mbeten një faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e detyrimeve financiare të Shqipërisë ndaj botës, këtë gjashtëmuaj kanë qenë 26 milionë euro më të ulëta: huamarrja shtetërore është rritur lehtë me rreth 1.2 milionë euro ndërkohë që, ndryshe nga viti i kaluar, përgjatë të cilit është vënë re prania e sektorit privat në huamarrjen afatgjatë, këtë gjashtëmuaj disbursimet e huave të këtij sektori kanë qenë më të ulëta (rreth 27 milionë euro më pak).

Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit dhe të interesit vlerësohen në rreth 25.5 milionë euro, të barasvlefshme me 10 për qind të eksportit të mallrave.

Nga ana tjetër, pretendimet financiare të Shqipërisë ndaj pjesës tjetër të botës janë rritur me 26 milionë euro. Rritja e mjeteve është përcaktuar kryesisht nga rritje në investime portofoli të njësive rezidente jashtë, ndërkohë që mjetet e zotëruara nga sistemi bankar në formën e depozitave jashtë kanë ardhur në rënie.

Stoku i mjeteve financiare në formën e investimeve të portofolit, në fund të periudhës, kapi shumën 164 milionë euro, me një fluks gjashtëmuajor në rritje prej 48.1 milionë eurosh. Në përbërjen strukturore sipas monedhave 47 për qind i përkasin atyre në dollarë, 52 për qind në euro dhe 2 për qind në stërlinën angleze. Mjetet valutore të zotëruara nga sistemi bankar në formën e depozitave jashtë, kanë rënë me rreth 37 milionë euro. Në përbërjen e depozitave të zotëruara nga sistemi bankar, dollari amerikan zë 56 për qind të tyre, ndërsa pjesa tjetër është në monedhëm evropiane (40 për qind) dhe stërlina angleze (3 për qind). Gjithashtu, në rënie vlerësohen mjetet valutore cash. Në përbërjen strukturore sipas monedhave, mjetet valutore cash në dollarë amerikanë zinin 39 për qind dhe ato në euro 53 për qind, stërlina angleze 8 për qind.

Flukset hyrëse të mjeteve valutore në formën e kapitaleve financiare u reflektuan në rritje të rezervave valutore të autoritetit monetar, me rreth 11 milionë euro. Niveli i rezervave valutore bruto, në fund të periudhës, u

vlerësua në 1 miliard e 72 milionë euro, i mjaftueshëm për të përballuar 4.6 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

**Bilanci i Pagesave**  
në milionë EURO

	3mI 2004	3mII 2004	3mIII 2004	3mIV 2004	3mI 2005	3mII 2005
Llogaria korente	-36.9	-94.7	-25.5	-129.0	-44.8	-100.5
Eksporti i mallrave	109.1	129.9	121.6	125.0	121.5	143.3
Importi i mallrave	-363.5	-427.0	-453.7	-518.1	-398.0	-507.0
Bilanci tregtar	-254.4	-297.1	-332.1	-393.1	-276.5	-363.7
Shërbimet: Kredi	176.5	206.1	223.8	201.1	201.7	239.5
Shërbimet: Debi	-166.8	-221.9	-229.0	-230.4	-226.4	-257.6
Të Ardhurat: Kredi	34.2	34.7	55.8	39.3	39.3	41.1
Të Ardhurat: Debi	-4.4	-7.0	-5.1	-6.8	-4.9	-9.6
Transferta private pashpërbllim	166.2	176.6	244.5	242.3	210.3	243.3
Transferta shtetërore pashpërbllim	11.7	13.8	16.7	18.5	11.8	6.5
Llogaria kapitale	27.2	21.3	29.1	28.5	35.5	14.6
Llogaria financiare	18.3	183.7	-15.2	110.7	22.4	124.0
Investime direkte	28.0	138.1	58.7	42.6	43.3	50.3
Investime portofoli	-1.1	3.3	98.2	-95.9	-42.9	-5.2
Kapitale të tjera*	-8.7	42.3	-172.2	164.0	21.9	78.9
Gabime dhe harresa neto	-1.5	-12.4	84.9	35.6	-8.0	-36.7
<b>Bilanci i përgjithshëm</b>	<b>11.8</b>	<b>97.9</b>	<b>78.1</b>	<b>45.9</b>	<b>9.7</b>	<b>1.4</b>
<b>Rezervat dhe zëra të lidhur me to</b>						
Mjetet e rezervës	-11.8	-97.9	-78.1	-45.9	-9.7	-1.4
Përdorim huash e kredish nga FMN	4.8	0.0	4.8	0.0	4.6	0.0
<b>Për t'u mbajtur në vëmendje</b>						
Ndryshimi total në rezerva	-2.1	-94.5	-84.4	-95.2	15.7	35.3
nga të cilat: ndryshim nga kursi i këmbimi	-9.8	-3.4	6.3	49.3	-25.4	-36.7

\*/ nuk përfshihen përdorime huash e kredish nga FMN